



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.2. pikën a) si dhe lidhur me nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin d) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Eko term" Sh.P.K. të datës 24.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 19.05.2023 të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i varrezave dhe hapësirave në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-22-11826-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 178 521, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Eko term" Sh.P.K. e datës 24.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 19.05.2023 të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i varrezave dhe hapësirave në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-22-11826-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 178 521.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Eko term" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Eko term" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi) me datë 24.05.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 19.05.2023 të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i varrezave dhe hapësirave në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-22-11826-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 178 521.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimi i parashtruesit janë cituar si në vijim:

- I. **Pretendimi i parë** – “OE ka deshtuar te plotesoj kerkesen teknike dhe profesionale pika 2.4 ku kerkohet qe te ofrohet dokument (Dud ose kontrate apo fatur blerje) per paisjen teknike EKSAVATOR”.
- II. **Pretendimi i dytë** – “kontrata e prezantuar per punonjesen ne fjale (Mirvete Demiri) dhe deklarimi per kete punonjese ne ATK, jane ne kunderthenje”.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 56, 59, 60, 65, 66, 72 dhe 108/ A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 26.05.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Për shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- B05 Njoftimi për kontratë i dt. 07.11.2022.
- Dosja e tenderit e dt. 07.11.2022.
- Proceverbali i hapjes i dt. 30.11.202.
- Oferta e tenderuesit të suksesshëm Muhamet Muçiqi.
- Njoftimi mbi vendimin i dt. 28.12.2022.
- Raporti vlerësimit i dt. 19.05.2023.
- Njoftimi mbi vendimin i dt. 19.05.2023.

Lidhur me pretendimin e parë (I) janë administruar si prova dosja e tenderit, oferta e tenderuesit të suksesshëm dhe raporti i vlerësimit të tenderëve. Me këtë rast nga oferta e tenderuesit të suksesshëm dhe nga raporti i vlerësimit të tenderëve është gjetur se tenderuesi i suksesshëm i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në kuadër të kapacitetit teknike dhe profesional ashtu që ka plotësuar aneksin 7 të DT si dhe ka dorëzuar te autoriteti kontraktues dëshmitë e kërkuara dokumentare lidhur me këto kriteret. Prandaj ky pretendim i parashtruesit është tërësisht i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) fillimisht duhet cekur që sipas DT (9.1 & 9.2) është përcaktuar se “OE duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme a) një menaxher-inxhinier të ndërtimtarisë ose bachelor si dhe b) minimum

2 saldues të çertifikuar". Dëshmitë dokumentare të kërkuara me këtë rast janë "a) Per Inxhinieret apo Becheloret të dorëzohet CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. b) OE duhet të dorëzojë certifikatat e salduesve kontrata e punës apo Marrëveshja mbi angazhimin e tyre". Me këtë rast janë administruar si prova dosja e tenderit, oferta e tenderuesit të suksesshëm dhe raporti i vlerësimit të tenderëve. Nga oferta e tenderuesit të suksesshëm dhe nga raporti i vlerësimit të tenderëve është gjetur se tenderuesi i suksesshëm i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në kuadër të kërkesave të përshtatshme dhe kapaciteteve teknike dhe/ose profesionale. Në anën tjetër duhet potencuar se parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi apo provë me të cilën do të vërtetonte pretendimin e tij. Pra pretendimi i tij nuk mbështetet në asnjë provë apo dëshmi materiale që ka mundur të bashkangjitet së bashku me kërkesën për rishqyrtim. Në këtë mënyrë nga provat materiale të administruara është gjetur se ky pretendim i parashtruesit është tërësisht i pabazuar.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 26.05.2023

Visar SHEHU



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.